

ETHICS IN RESEARCH WORKS

Nexhmije Kabashi

College Biznesi, Prishtina, Kosovo, nexha63@live.com

Abetare Kabashi

College Biznesi, Prishtina, Kosovo, abetare@live.com

Abstract: Everyone, wanting to deal with research science knowing that without enabling the methodology can not succeed in his field of interest. The method is more precisely the research that is applied in a scientifically known way. It is completely better, but can be separated from its research areas. Every science has its own methods. Science, which has no methods of its own is dead science. The sciences, having the need to study, can be distinguished from each other only in the manner of tire study methods. The methodology in its study basically includes the following problems: The scientific system, which you want to find characteristic: systematization of service knowledge of service science, consistency, announcement of realized creations, verification of facts, study and special tools science which science that the value and importance of these research methods are added even more when combined with scientific and ethical, and who intends, that forbids them with negative and unhelpful actions and cultivates only good and beneficial actions etc. and individual and social behavior in order to realize its principles (ethics), usefulness, law, direction and sincerity. Regarding the importance of research ethics of information and communication and sincere are elaborated in the following paper.

The purpose of the research: We can say that the key to success in realizing desires and also to have a career. which may include various aspects is Ethics. The paper deals with ethics, as it is an important component for business. This is the purpose of this paper, to address ethical issues related to information and communication.

The analysis is not comprehensive, as the issue itself is very broad, but only a few more minor points are addressed. The paper presents the problems of research, collection, processing and communication of information in business enterprises and business ethics as a necessary element for good organization, the fruits of which are transmitted to society from a normative point of view.

Reasonability of the work: The term ethics is encountered everywhere, such as professional ethics, media ethics, business ethics, which refers to the rules, principles and standards that guide the behavior and actions of business organizations. But the essence in all these areas is ethical responsibility and the way you adhere to it, intertwined with responsibility.

From ancient Greek philosophers to the present day ethics has been defined and divided into various aspects as part of philosophy. However, briefly and simply it can be said that ethics is a system of moral principles or a code of conduct of social, religious or civil groups, which clarifies good from evil and the individual's choice to do what is good. Ethics as a science on morality is not a new topic for discussion, it has been discussed, debated for thousands of years in all cultures, countries, states, communities and regions of the world. new, but its application is finding more and more place in science and business life.

Keywords: ethics, information, business, communication

ETIKA NE PUNET KERKIMORE

Nexhmije Kabashi

Kolegji BIZNESI Prishtinë, nexha63@live.com

Abetare Kabashi

Kolegji BIZNESI Prishtinë, abetare@live.com

Abstrakti: Secili ,që dëshiron të merret me shkencë duhet ditur se pa e njohur metodologjinë nuk mund të arrin sukses në sferën e interesimit të tij. Metoda është mënyrë e hulumtimit që zbatohet në ndonjë shkencë. Ajo është pjesë përbërëse asaj shkence dhe nuk mund të ndahet nga lëmit e saj hulumtuese. Çdo shkencë ka metoda të veta. Shkenca, që nuk ka metoda të veta është shkencë e vdekur. Shkencat, që kanë lëndë të njëjtë të studimit, mund të dallohen mes veti vetëm në bazë të metodave të studimit të tyre.

Metodologjia në studimin e saj në princip në vete ngërthen këto probleme: Sistemin shkencorë, që duhet ti përmban këta karakteristika: sistematizim të njohurisë së arritur të shkencës së caktuar, konsekuencë, kumtim të njohurive të arritura, verifikimin e fakteve, mjetet studiuuese dhe teknike të cilat shkencës që hulumtohet i shërbejnë në hulumtimin, mënyra e zhvillimit të shkencës që hulumtohet, libra të disiplinës së caktuar shkencore. Vlera dhe

rendesia e ketyre metodave kerkimore u shtohet edhe me teper kur kombinohen edhe me shkencen e etikes, e cila ka per qellim, qe te ndaloj te gjitha veprimet negative dhe jo te dobishme dhe i kultivon vetem veprimet e mira dhe dobiprurese te te gjitha veprimeve dhe sjelljeve individuale e shoqerore me qellim te realizimit te parimeve te saja (etikës), dobishmerine, te drejten, drejtësinë dhe sinqeritetin. Sa i perket rendesise se etikes kerkimore të mbledjes se informacioneve, qe duhet te jene te sinqerta jane te shtjelluara ne punimin ne vijim.

Qëllimi i hulumtimit: Mund te themi se çelësi i suksesit në realizimin e dëshirave dhe për të pasur gjithashtu një karrierë, e cila mund të përfshijë aspekte të ndryshme është Etika. Punimi ka të bëjë me aplikimin e Etikës, duke qenë se është një komponent e rëndësishme për biznesin. Ky është qëllimi i këtij punimi, që të trajtojë çështjet etike që lidhen me mbledhjen e informacioneve.

Analiza nuk është gjithëpërfshirëse, pasi që vetë kjo çështje është shumë e gjerë, por trajtohen vetëm disa pika më të rëndësishme. Në punim paraqitet problematika e hulumtimit, mbledhjes, përpunimit dhe komunikimit të informacioneve në ndërmarrjet biznesore dhe etikës biznesore si një element i domosdoshëm për mirëorganizim, frytet e së cilës transmetohen në shoqëri nga këndvështrimi normativ.

Arsyeshmëria e punimit :Termin etikë e hasim kudo si p.sh etika profesionale, etika e medias, etika e biznesit, e cila ka të bëjë me rregullat, parimet dhe standartet që orientojnë sjelljen dhe veprimet e organizatave të biznesit. Por thelbi në të gjitha këto fusha është përgjegjësia etike dhe mënyra se si ti përmbahesh asaj, e ndërthurur me përgjegjësinë .

Që nga filozofët e lashtë grek e deri më sot etika është përkufizuar dhe ndarë në aspekte të ndryshme si pjesë e filozofisë. Gjithsesi përmbledhur shkurt dhe thjesht mund të thuhet se etika është një sistem i parimeve morale apo një kod i sjelljes së grupeve shoqërore, fetare apo civile, i cili qartëson të mirën nga e keqja dhe zgjedhjen e individit për të bërë atë që është e mirë. Etika si shkencë mbi moralin nuk është një temë e re për diskutim, ajo është diskutuar, debatuar gjatë mijëra vjetëve në të gjitha kulturat, vendet, shtetet, komunitetet dhe rajonet e botës. Kurse sa i përket Etikës në aplikimin e shkencave biznesore është shkencë më e re , por apliimi i saj po gjen vend gjithnjë e më tepër në shkencat dhe jetën biznesore.

Fjalet kyçe: etikë, informacion, biznes

1. KUPTIMI I ETIKËS

Etika nuk është një temë e re për diskutim, ajo është diskutuar, debatuar gjatë mijëra vjetëve në të gjitha kulturat, fetë, vendet, shtetet, komunitetet dhe rajonet e botës. Pavarësisht nëse konteksti është publik ose privat, ndërkombëtar ose lokal, në nivel organizate ose privat, çështja e etikës ka qenë dhe është në thelb të këtyre problemeve të ngritura.³⁵

Fjala etikë buron nga shprehja greke "ethos", "ethikos" që nënkupton moralin, qe ka domethënie e traditës, dokeve dhe shprehive³⁶.

2. KONCEPTIMI DHE PERKUFIZIMI I ETIKES SE BIZNESIT

Ne një studim te kryer nga Raymond Baumhort, gjate intervistimit që ka bërë në një mori menaxherësh për pyetjen se ç' do te thotë termi "etikë" – ka marr këto përgjigje:

-”ajo qe ndiej se është e drejte , 25% e përkufizojnë me terma religjioze te tilla si “pajtim me besimin fetar” dhe 18% e përkufizojnë “me pajtim me rregullën e artë”.³⁷

Termi etikë ka të bëjë me parimet e udhëheqjes së një individi apo grupi njerëzish (individësh), prandaj dallojnë termet si:³⁸

“Etike personale” d.m.th një individ merret me aplikimin e saj (p.sh. Rregullimi jetës se vet)

“Etikë profesionale” – i referohet kodit te udhëheqjes ne një profesioni te caktuar (p.sh) profesionistet ne fushën e kontabel apo kimistët etj.)

Sipas Brownen H. MecLay, drejtor I mendimit te shoqeris “Morgan Stanley & Company” në SHBA, etika perkufizohet:

“...Ajo (etika) perfshin artin e integritimit dhe te kompromisit dhe jothjesht bindjen e Konformitetin e verber. Etika kerkon tolerancen ndaj paqartesive, per me teper ajo perben nje proces nderpersonal me veprim te orientuar...”

³⁵ Kodi Boteror i Etikes ne Turizem, Republika e Kosoves, Ministria e Tregtise dhe Industries

³⁶ Paviqeviq Vuko, Bazat e Etikës, Rilindja, Prishtinë, 1981, fq 8

³⁷ Hysen Cela,,Etika dhe Biznesi”Tirane,2003, fq.32

³⁸ Po aty, fq 32

3. BOTA AKADMIKE DHE ETIKA E BIZNESIT

Nuk ishte aq e mirëpritur, sepse hasi në dy vështirësi:

Së pari – për shkak të dyshimit që aktiviteti i etikës së aplikuar nuk do ta përballoj dot analizën akademike pra, ndaj profesionistëve të etikës ndihej një lloj përbuzje.

Së dyti – akademikët ishin septikë, se etika dhe biznesi nuk mund të bashkëjtonin.

EBEN-it (rrjeti Evropian i Etikës së Biznesit) “Historia premtues” – në vitet e 90-ta- Sipërmarrje përgjegjshme.

Në vitet e 90-ta bazuar në forcën reale të palëve u arrit që të takohen me njëra tjetrën “Biznesi” dhe “Shoqëria”.

Në vitet e 80-ta vërehej dukuria se më shumë vende evropiane “qeveria po e tërhiqte veten ng arema publike” (p.sh sigurimet shoqërore, sistemet e pensionit dhe stimulimi i punësimit) dhe transferi i obligimeve publike në aktorët privat, qofshin ato korporata, degë apo edhe punonjës individual.

Standardet për tu zbatuar gjykimet morale janë shumë komplekse ato mvaren nga kriteret, kualifikuese, përjashtime kifizuese etj..

Por për vlerësimin e tyre eticitetet përdoren kriteret e ndryshme, siq janë:

1. Arsyetimi duhet të jet **logjik**,
2. Faktet duhet të jenë **te sakta**, të lidhen me gjykimin në fjale dhe të jen **te plota**,
3. Standardet morale që përdoren me arsyetimin moral të një individi duhet të jen **te qendrueshme**

4. ASPEKTET KRYESORE QË TRAJTOHEN NGA ETIKA E BIZNESIT

Aspektet kryesore, që trajtohen nga Etika e Biznesit janë:

1. **Ç`orientimi (keqduhezimi) menaxherial** - ka të bëjë me studimin e shkaqeve, që e kanë sjell në këtë gjendje dhe analizën e formave se si të dilet nga gjendja e krijuar.
2. **Konfuzionet morale** – (konflikti potencial i interesave përdorimi i gabuar i resurseve, keqmenaxhimi i kontratave etj.)

Njeriu gjatë gjithë jetës së tij ndodhet para dilemave për të vendosur se çfarë është e “drejtë”, “e duhur” dhe “e sinqertë”.

Menaxheret e ndryshëm ndodhen në pozicionin e ndërmjetësuesit në mes të epurorëve të vet dhe në mes të bartëseve të procesit të prodhimit, prandaj me shumë konsideratë duhet të gjej mënyrat se si t'i raportoj lajmet e këqija të epurorëve të tij, si dhe në anën tjetër si të nxisë procesin e prodhimit ose shërbimet etj.

Të gjitha qeshtjet “e drejtë”, “e duhur”, “e sinqertë” në realitet janë mendime etike. Këto aprovohen nëpërmjet organizatave të biznesit të cilat kanë të bëjnë me atë, se;

- Mënyra e trajtimit të punëtorëve,
- Mënyra e përcaktimit të çmimeve të produkteve dhe shërbimeve,
- Mënyra e mbrojtjes së mjedisit
- Plotësimi i përgjegjësisë sociale etj.

5. ETIKA NË PUNËT KËRKIMORE

Me rastin e mbledhjes se të dhënave përmes anketës na paraqiten disa probleme:

- Disa të anketuar nuk do të pranojnë bashkëpunimin,
- Disa të tjerë nuk do të ndodhen në shtëpi dhe do të na duhet të tentojmë përsëri të vëmë kontakt me ta,
- Disa mund të na japin përgjigje të gabuara dhe jo të sinqerta, dhe
- Disa të tjerë mund të jen shumë subjektive gjatë dhënies së përgjigjeve.

6. QASJET DHE TEKNIKAT E PUNËVE SHKENCORE –KËRKIMORE

Problemi i njohjes së tregut shprehet më së shumti të ndërmarrjet e mëdha, të cilat janë të larguara fizikisht nga konsumatorët dhe kështu nuk kanë mundësi që nëpërmjet vëzhgimit të drejtpërdrejtë dhe dijes personale të menaxherëve t'i zbulojnë reaksionet dhe sjelljet e konsumatorëve në treg.³⁹

Procesi efikas i kërkimeve të tregut, sipas PH Kotlerit përfshin në vete pesë faza, të cilat janë:⁴⁰

- Përkufizimi i problemit dhe i qëllimeve kërkimore,
- Përpilimi i planit kërkimor,
- Mbledhja e të dhënave,
- Përpunimi dhe analiza e të dhënave,

³⁹) B.C.Veku dhe N.Rashidi,, Marketingu”2006 , fq.68

⁴⁰) B.Ceku , N.Rashidi,,Marketingu”2006Prishtine ,fq74

- Prezantimi dhe interpretimi i rezultateve.




Fig 1: Fazat e procesit të kërkimeve të tregut sipas PH. Kotler - it




Fig 2: Elementet e planit kërkimor

Përcaktimi i punimit kërkimor shkencor (motivet, ekskluziviteti, synimi); Kornizimi I tezave dhe i nëntezave përmbajtësore dhe plani i punës (vëllimi i punimit, ilustrimet e parapara, kohëzgjatja e hartimit, destinimi); Grumbullimi i të dhënave dhe fakteve (kërkimet hulumtuese dhe analizat kualitative, kërkimet e bazuara në të dhënat parësore: kërkimet e bazuara në anketime, kërkimet e llojeve tjera: të komunikimit efektiv mererpondentë, metodat e vështrimit, kërkimet eksperimentale); kërkimet e bazuara në të dhënat dytësore (shfrytëzimi i literaturës, i bibliografisë përkatëse në biblioteka, në internet, leximi dhe përpunimi, konsultimi i literaturës së zgjedhur, shfrytëzimi i skedarëve bibliotekarë, i skedave vetjake dhe përdorimi i tyre; Hartimi i punimit (veprës) shkencore e profesionale (zgjedhja e stilit, korrektësia, qartësia dhe konciziteti, optimumivëllimor i veprës); Struktura e punimit shkencor kërkimor; Shfrytëzimi i burimeve për të përforcuar relevancën shkencore; Tabelat grafikonet dhe inkorporimi i tyre në punim; Shqyrtimi i hartimit të tabelave statistikore në saje të elementeve të dhënë, metodat statistikore matematikore, ndërtimi i grafikoneve dhe të nxënia e leximit të tyre; Disenjimi teknik i punimit shkencor kërkimor.

7. PËRFUNDIMI

Aplikimi i metodave etike në hulumtimet shkencore ka një rëndësi të pazhvendësueshme në sukseset apo qëllimet e cdo ekonomie kobëtare dhe të shoqërisë globale.

Në këtë punim është vënë në pah rëndësia e Etikës, në disa sfera, por sidomos në sferën e metodologjisë shkencore-hulumtuese në bledhjen e të dhënave shkencore. Është paraqitur rëndësia e mjedisit ku vepron Etika, qasjen në punët kërkimore, karakterin e punimit shkencor, llojet e burimeve të kërkimeve, planifikimin për mbledhjen, përpunimin, analizimin dhe prezantimin e të dhënave kërkimore. Janë me rëndësi primare qëndrimet e menaxherëve ndaj kërkimeve dhe hulumtimeve, sepse siqë e dime harmonizimi I Etikes me punët kërkimore është mjaft e vështirë, që të zbatohet në praktikën e përditshmërisë shoqërore dhe sidomos praktikën afariste.

LITERATURA

- Batkoska, L. (2005). „Metodologjia na naucnoto istrazivanja” Ohrid
- Benson, (2000). *Environmental Ethics*, Routledge, London UK
- Ceku, B., & Rashidi, N. (2006). „Marketingu” Prishtine
- Çela, H. (2003). „Etika dhe Biznesi” Tiranë
- Jakupi, A. (2005). „Metodologjia e Punës Shkencore Kërkimore” Ligjërata të autorizuara Prishtinë
- Jacob, M. A. (2019). Under repair: A publication ethics and research record in the making. *Social studies of science*, 49(1), 77-101.
- Kodi Boteror i Etikes ne Turizem, Repiblika e Kosoves, Ministria e Tregtise dhe Industries
- McKenna, L., & Gray, R. (2018). The importance of ethics in research publications. *Collegian*, 25(2), 147-148.
- Paviqeviq, V. (1981). Bazat e Etikës, Rilindja, Prishtinë
- Reijers, W., Wright, D., Brey, P., Weber, K., Rodrigues, R., O’Sullivan, D., & Gordijn, B. (2018). Methods for practising ethics in research and innovation: A literature review, critical analysis and recommendations. *Science and engineering ethics*, 24(5), 1437-1481.
- Resnik, D. B. (2015). What is ethics in research & why is it important. National Institute of Environmental health sciences.
- Resnik, D. B. (2018). *The ethics of research with human subjects: Protecting people, advancing science, promoting trust* (Vol. 74). Springer.